



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3137/5 prot

Datë 14.11.2025

V E N D I M
Nr.1681/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.11.2025 me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Advanced Busines Solution-ABS” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar- Mallra”, me objekt: “Blerje Software dhe licensa”, me me REF-66832-10-27-2025, me fond limit 8.977.948 (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) Lek pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a

Ankimues: “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK me NIPT K21710002J dhe adresë Rruga "Murat Toptani", Godina Eurocol, Kati 8, Tiranë, Shqipëri

Autoriteti Kontraktor: Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.
Adresa: “Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 24 e vijues, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.10.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar- Mallra”, me objekt: “Blerje Software dhe licensa”, me REF-66832-10-27-2025, me fond limit 8.977.948 (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) Lek pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a.

II.2. Në datën 04.11.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6042 dhe me nr. 31376 prot., datë 04.11.2025 e operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK me anë të së cilës kërkohet modifikimi i kriterëve të veçanta të procedurës së prokurimit të sipërcituar duke kërkuar modifikimin e pikës 2.5. të kriterëve të veçanta ku shprehimisht parashikohet që “Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesi i licensave të kërkuara për shitjen dhe suportin për territorin e Republikës së

Shqipërisë (të dorëzojë MAF përkatës). Autorizimi duhet të jetë i dedikuar për objektin e prokurimit dhe të përmbajë kontaktet e nevojshme (emër, email, telefon) për të verifikuar autenticitetin e tij.” Operatori ekonomik ankimues ka kërkuar që ky kriter të modifikohet si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesi ose distributori i licensave të kërkuara për shitjen dhe suportin për territorin e Republikës së Shqipërisë (të dorëzojë MAF ose DAF përkatës). Autorizimi nga Prodhuesi ose Distributori duhet të jetë i dedikuar për objektin e prokurimit dhe të përmbajë kontaktet e nevojshme (emër, email, telefon) për të verifikuar

autenticitetin e tij. Në rast dorëzimi të DAF, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton lidhjen zyrtare ndërmjet distributorit dhe prodhuesit.”,

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesa e plota të ankimuesit.

II.4 Nëpërmjet shkresës nr. 15778/7 prot., datë 10.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3137/2 prot., datë 12.11.2025 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor e ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e pikës 2.5. të kriterëve të veçanta duke argumentuar si më poshtë:

“....Pas shqyrtimit të argumentave të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues dhe dokumentave standarte të tenderit të vëna në dispozicion nga njësia e prokurimit, Komisioni i shqyrtimit të ankesave vlerëson se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues është i drejtë dhe i bazuar. Autoriteti kontraktor do të bëjë përditësimin e dokumentave të tenderit duke e pasqyruar në sistemin elektronik të prokurimeve (SPE) nëpërmjet një shtojce.

Komisioni i shqyrtimit të Ankesave bazuar në të gjithë rrethanat e sipërpërmendura, vlerësojmë se ankesa e operatorit ekonomik qëndron dhe si rrjedhojë pranohet...”

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës së autoritetit kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a nr. 15778/7 prot., datë 10.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3137/2 prot., datë 12.11.2025 rezulton se ankesa është pranuar plotësisht.

II.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 114 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se:

1. *Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. *Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.*

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. *Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:*

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.*

4. *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*

5. *Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.*

6. *Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i shkresës nr. 15778/7 prot., datë 10.11.2025, , të dorëzuar pranë KPP-së në datë 12.11.2025, nga autoriteti kontraktor, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranim plotësisht të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këtë pretendim, për sa kohë ajo është pranuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së

Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar- Mallra”, me objekt: “Blerje Software dhe licensa”, me REF-66832-10-27-2025, me fond limit 8.977.948 (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) Lek pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Autoriteti kontraktor, të kryejë modifikimet e DST sipas konstatimeve të KSHA për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Florent Zguro

